

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (5)

Nëse lufta nuk mund të evitohej, ajo mund të përfundonte më herët

Kritikët shpesh e kanë quajtur Izetbegoviqin fundamentalist. Ai dëshironte të kthehej te origjina e islamit. Mirëpo, ai ishte një njeri bashkëkohor, i cili i kritikonte regjimet autoritare dhe i mbronte të drejtat e pakicave

Ishin kryesisht serbët të cilët e justifikonin politikën e tyre agresive duke refuzuar të praninin statusin e minoritetit. Siç ka thënë Nikola Koleviq, serb nga Bosnja më 1992: “Mund ta kuptoj frikën e myslimanëve nga dominimi serb apo kroat..., por nuk mund ta kompensoni këtë duke i vënë serbët në pozitë të minoriteteve”. Nuk kanë menduar kështu të gjithë serbët. Në zgjedhjet e vitit 1990, serbët e Kroacisë kanë votuar kryesisht koalicionin që më së shumti i është afruar fillimit të demokracisë civile. Më shumë se gjysma e serbëve që kanë jetuar në Kroaci kanë jetuar në pjesët e urbanizuara të vendit, dhe shumica e tyre u patën “kroatizuar”. Roksandiq tregon se edhe nëse lufta nuk ka qenë e evitueshme, së paku ka mundur të jetë shumë më e shkurtër, “do të mund të krijohej një koalicion punues kroato-serb për të mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin e Republikës së Kroacisë”. Por, kjo do të kërkonte kohë dhe kuadro të dyanshme të politikanëve serbë dhe kroatë, si dhe vullnet për të punuar së bashku jashtë lidhjeve të homogjenizmit nacional. Asnjëra nga këto nevoja

nuk ishte plotësuar më 1990 - 1991. Në këtë mënyrë, edhe para se Kroacia dhe Sllovenia të shpallnin pavarësinë e tyre më 1991, serbët të pakënaqur nga pjesët më pak të zhvilluara dhe më konservative të rajoneve rurale të Kroacisë, shpallën pakënaqësitë e tyre për të humbur statusin e popullit kushtetues. Në Bosnjë, ushtarë të ngjashëm serbë, duke u frikësuar se do të shkrihen në një shtet islamik, dhe me armët e siguruara nga shkatërrimi i ushtrisë nacionale jugosllave, gjithashtu u gjendën në revoltë. Katër vjet të luftimeve të gabuara, kanë sjellë shtrirje të plotë të pastrimit etnik, masakra dhe lëvizje masive të refugjatëve. Përfundimisht, më 1995, intervenimet ndërkombëtare dhe ofensiva e suksesshme kroate në Krajinë dhe në veriperëndimin e Bosnjës, e ka ndalë luftën. Njëra nga arsyetimet serbe më të shpeshta ka pretenduar se serbët në Bosnjë janë frikësuar nga udhëheqësi mysliman Alia Izetbegoviq, i cili, sipas tyre, ka qenë një fundamentalist fetar dhe është parë si themelues i mundshëm i një diktature islame mbi Bosnjën. Të gjithë

mbikëqyrësit e jashtëm janë pajtuar se kjo ishte një akuzë false, por për shkak se kishte një marrëveshje të mirë të rezonancës mes serbëve, një vështrim më i afërt me pikëpamjet e Izetbegoviqit është justifikues. Vetëm 2 vjet pas lindjes së Izetbegoviqit më 1925, ai dhe familja e tij janë shpërngulur në Sarajevë, e cila ka qenë shtëpia e tij deri në vdekje, më 2003. Izetbegoviq ka mbaruar gjimnazin më të mirë në Sarajevë, dhe si i ri gjatë Luftës së Dytë Botërore ka qenë anëtar në një grup të quajtur “Myslimanët e Rinj”. Nëse shihet si një pasqyrim i dëshirës së myslimanëve të Bosnjës për të pasur një të ardhme politike si një grup nacional, ky organizim i të rinjve mund të krahasohet me “Omladinën Serbe” të shekullit të nëntëmbëdhjetë, ose të grupit “Italia e Re” të Mazzinit, që të dyja kanë përdorur termin “i ri” që nënkupton se vendi i tyre është ende në fazën e formimit, por ka një të ardhme të ndritshme. Interesi primar i këtij grupi ishte rigjenerimi i islamit, dhe për këtë arsye të gjithë anëtarët kanë qenë antikomunistë. Vetë Izetbegoviqi, si i ri, ka qenë

i interesuar për një kohë të shkurtër në marksizëm, por ai nuk ka mundur të pranojë ateizmin e komunizmit. “Universi pa Zot më dukej i papërfytyrueshëm”, ka thënë ai në shënimet biografike të tij. Aktivitetet e “Myslimanëve të Rinj” kanë pasur pak adhurues në mesin e të rinjve boshnjakë antikomunistë në fund të luftës, komunistët e burgosin Izetbegoviqin dhe shumë të tjerë. Pas lirimit, ai ka studiuar agronominë për një kohë, por në fund diplomoi në drejtësi dhe punoi për disa vjet në ndërmarrjet e ndërtimit në Mal të Zi. Dokumenti kryesor në të cilin serbët e Bosnjës e kanë bazuar frikën e tyre nga Izetbegoviqi ishte deklarimi islamik i tij në një formulim rreth rigjenerimit të islamizmit, që filloi të qarkullojë ndër myslimanë të Bosnjës më 1970. Deklarata, brenda traditës së shkrimeve liberale islamike, u pa si një rrugë për myslimanët për të ringjallur besimin. Në të Izetbegoviq e ka ndier se edukimi islamik ka rënë dhe se ai shihte stagnim kudo në botën islame. Në mënyrën e shumë reformistëve fetarë të të gjitha besimeve, Izetbegoviqi e

shihte pastërtinë e islamit të njollësuar nga mospajtimi ndërmjet botës dhe veprave. Kritikët shpesh e kanë quajtur Izetbegoviqin fundamentalist. Ai dëshironte të kthehej te origjina e islamit. Por, ai ishte gjithashtu një njeri bashkëkohor, i cili i kritikonte regjimet autoritare, i ka parë përparimet në arsim, dhe ka mbrojtur të drejtat e minoriteteve. Çfarëdo tjetër që ai ka parë, Izetbegoviqi ka dashur që populli i tij, myslimanët e Bosnjës, të kenë mundësinë që të mbajnë kokën lart në botën e asaj kohe, në të cilën ata nuk kishin hyrë ende në një mënyrë të duhur. Deklarata ishte pothuajse një dokument në kohën e tij, në të dy bindjet, islamike dhe evropiane. Në deklaratë, Izetbegoviqi ndiqte një rrugë të vështirë të bindjeve islamike, të emëruara si t'i koordinojmë rregullat islamike me sfidat e jetës aktuale në botën moderne.

(Në numrin e ardhshëm: Çka ndodhi pas ardhjes së Izetbegoviqit në krye të Bosnjës? Pse dështuan përpjekjet për riorganizimin e federatës?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (7)

Masakra e Adonisit

Kur Richard Lonergan dhe njerëzit e tij hynë në klubin “Adonis”, Al Capone ishte i ulur në një separe dhe nuk e ktheu as kokën që të shikonte se çka po ndodhte. Ai vetëm i lëvizi pakëz sytë në drejtim të tyre. Pak sekonda më pas shumë njerëz mbetën të vdekur. Kishin vdekur njerëzit e Capones apo të Logermanit?



Al Capone (me kapelë të bardhë) e kishte ditur se Lonergan do të vinte atë natë në klubin “Adonis” për të bërë telashe, por nuk e kishte bërë të madhe atë punë

Menjëherë pasi Johnny Torrio ia la trashëgim të gjithë “perandorinë” e tij të nëntokës, Al Capone i ndryshoi sjelljet. Pushteti i tij ishte i madh. Që të dëshmonte këtë pushtet, ai e ndërroi zyren. U vendos në hotelin më të shtrenjtë të Chicagos, në Hotel Metropol, ku e mori me qira një suitë me pesë dhoma që kushtonte 1.500 dollarë të atëhershme në ditë. Filloi të shoqërohej me gazetarin Harry Read, i cili e këshillonte si të sillej në publik. “Bëhu i mirë me njerëzit”, e mësonnte Read. Capone dinte t’i pranonte këshillat. Para njerëzve ishte gjithnjë gjentil, i shoqërueshëm, zemërgjerë. Vitet njëzet në Chicago, ishin vite kur gati secili njeri i rritur pinte alkool në sasi të madhe, kështu që njeriu që ua shiste alkoolin ishte njeri i respektuar. Mirëpo, krahas përmirësimit të statusit të tij social, Capone punoi për të pasur edhe ndikim politik. Vishej me shije, ishte i qetë, nuk imponohej ku nuk duhej dhe gjithnjë ishte i gatshëm për të ndihmuar bashkinë e qytetit. Natyrisht, secila ndihmë e tij e kishte edhe bishtin dikund dhe këtë më së miri e dinin nëpunësit e bashkisë.

Në këto rrethana, Al Capone e kishte brengë të vetme shëndetin e të birit të tij Albertit, i cili kishte

Gangsterë të tjerë të shquar Jacky Imbert

Jacky Imbert është mbreti i nëntokës në Francë që nga vitet gjashtëdhjetë. Është i dyshimtë për vrasje të shumta. “Policia shumë herë më ka marrë në pyetje për gjëra që nuk i kam bërë. Për ato që i kam bërë kurrë askush nuk më ka pyetur gjë”, ka thënë Imbert në një intervistë të dhënë në vitin 1993. Jack Imbert që njihet edhe me nofkën “Jacku i trentë” më 1963 është marrë në pyetje për herë të parë nga policia, kur ishte vrarë mafiozi Andrea Baptiste. Pas kësaj, Imbert ishte lidhur me gangsterin Gaetan Zampa. Mirëpo, më 1977, Zampa me dy burra të tjerë ia kishin bërë një pritë Imbertit dhe e kishin rrëzuar me një breshëri plumbash. Mjekët i kishin nxjerrë 22 polumba nga trupi i tij. Mirëpo, çuditërisht, kishte mbetur gjallë. Pas kësaj, 11 bashkëpunëtorë dhe miq të Zampas u vranë brenda një kohe të shkurtër. Jack Imbert është arrestuar nga policia më 2003, së bashku me një gangster rus. Në dhjetor të vitit 2004 është marrë vendimi i gjyqit. Imbert është dënuar vetëm me 4 vjet burgim. Tani është 75-vjeçar dhe pritet të dalë nga burgu në vitin 2008. Për veprat e tjera për të cilat dyshohet, prokuroria franceze nuk po mund të gjejë asnjë dëshmi.

infeksion kronik të veshit. Në dhjetor të vitit 1925, Capone e çoi të birin e tij në një vizitë mjekësore në New York dhe udhës u takua me ish-shefin e tij Frankie Yale. Në këtë takim dy gangsterët u pajtuan të bënin bashkë një biznes me kontrabandë të uiskit. Për ta kremtuar marrëveshjen, Yale e ftoi Al Caponen në një ndejë në klubin “Adonis” në lagjen Brooklyn. Ende pa nisur mirë ndeja, Frankie Yalet i vjen haberi se një gangster i quajtur Richard Lonergan do të vinte në klub, për ta prishur ndejën. Yale donte ta anulonte tërë ngjarjen, por Al Capone kërkoi që zbavia të mbahej gjithsesi.

Ndeja ishte shumë zbavitëse deri në tre të mëngjesit, kur njerëzit e Richard Lonerganit hynë në klubin “Adonis”. Me të hyrë brenda nisën të të bërtisnin dhe të thyenin gjëra. Al Capone ishte i ulur në një separe dhe vetëm i lëvizi pakëz sytë. Kjo lëvizje e

syve ishte urdhër për burrat e tij. Njerëzit e Lonerganit nuk arritën as t’i nxirrnin armët. Vdiqën të befasuar në një breshëri plumbash të orkestruar mirë. Ishte një masakër. U quajt Masakra e Adonisit. Me këtë veprim, Al Capone i tregoi muskujt e tij edhe në New York, por edhe tregoi se gangsterët e Chicagos ishin më të rrezikshëm se ata të New Yorkut. Gazetari Alva Johnson shkruante: “Chicagoja është kryeqyteti i gangsterëve, ndërsa New Yorku është vetëm periferi”. Alva Johnson në shkrimet e tij thoshte që atëherë se Al Capone ishte “gangsteri më i madh në historit”.

(Në numrin e nesërm: Si u shoqëruan katër irlandezë kundër Capones? Si e fyen ata mbretin e nëntokës? Kur nisi policia një fushatë kundër tij?)